



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- 410-33278

Me date 24.05.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", nenit 30 dhe 45 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e ne mbështetje te nenit 10 te Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, 01-Nr-016-20161 të datës 30.03.2021 Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrihen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për periudhën me pak se një (1) vit për Drejtorin për shërbime publike, emergjencë dhe mjedis ne këtë përbërje;

- 1.1 Berat KABASHI-----kryesues
- 1.2 Fisnik TAHIRI -----anëtar
- 1.3 Agron BAJRAKTARI -----anëtar

2. Detyrë dhe përgjegjësi e komisionit është që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrihen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për periudhën me pak se një (1) vit, se a i përmbushin kushtet dhe kriteret konform Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, 01-Nr-016-20161 të datës 30.03.2021 dhe t'i rekomandojnë Drejtorit të Drejtorisë përkatëse për nënshkrimin e kontratës.

3. Mandati i anëtareve të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave është dy (2) vite.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe e shfuqizon vendimin 01-Nr-020-31483 të datës 03.06.2021.



Kryetari i Komunës


Bali MUHARREMAJ

Te njoftohet;
Drejtoria e shërbimeve publike
Komisioni
Arkiva



Për: 
Bajraktari